



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E OBILIQIT - MUNICIPALITY OF OBILIC

No. dr. No. 01-052-01-1930-25

No. rrq. dr. sh. rrq. ...

Data: Datimi / Dat. 15.01.2025

OBILIQ - OBILIC - OBILIC



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E OBILIQIT**  
**OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC**

**KUVENDI KOMUNAL OBILIQ**  
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Raport i Punës (Janar- Dhjetor) 2024



# RAPORTI I PUNËS I KUVENDIT KOMUNAL

Janar- Dhjetor 2024



Në këtë Raport janë të përfshira të dhëna të përgjithshme sa i përket punës një vjeçare të Kuvendit Komunal të Obiliqit. Rezultatet e arritura gjatë këtij viti raportues kanë qenë mjaft inkurajuese duke pas parasysh angazhimin dhe përkushtimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal, për realizimin e të gjitha objektivave dhe synimeve në të mirë të banorëve të Komunës së Obiliqit.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur bashkëpunim edhe me ekzekutivin e komunës e në veçanti me Kryetarin e Komunës, i cili ka qenë shumë i hapur edhe inicues i shumë çështjeve të rëndësishme, në të mirë të banorëve të Komunës së Obiliqit.

Nuk ka mungu as bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK), me Kolegjiunin e Kryesuesve, me KFOR-in, OSBE-në, shoqëritë civile, qytetarët, mediat.

Në sistemin e vetëqeverisjes lokale, të Republikës së Kosovës, komuna është njësia themelore e vetëqeverisjes, ku i gjithë territory i Kosovës është i ndarë në 38 komuna.

Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës janë organet kryesore të komunës dhe që të dyja zgjedhen veç e veç dhe me vota të drejtpërdrejta të banorëve të komunës.

## Kuvendi i Komunës

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës në Komunë.

Përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës duhet të ushtrohen nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës, përveç nëse parashihen ndryshe me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera dhe Statutin e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Obiliqit i ka 21 anëtarë. Të gjithë anëtarët e Kuvendit kanë të drejta të njejta në proceset e Kuvendit.

## Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka përmbushur obligimin ligjor duke mbajtur:

- **12 (dymbëdhjetë)** mbledhje të rregullta (të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun).
- **3 (tri) mbledhje të jashtëzakonshme:**
  - 11.06.2024. Shqyrtimi i kërkesës dhe Peticionit të banorëve të fshatit Shipitullë.
  - 02.08.2024. Hapja e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapsinor-Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032.
  - 15.11.2024. Miratimi i Projekt - Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032.
- **2 (dy) mbledhje solemne:**
  - 06.03.2024 me rastin e shënimit të 26 vjetorit të Epopesë së UÇK-së.
  - 14.06.2024 për nder të 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit.

Emri i Komunës	Mbledhje rregullta	Mbl. Jashtëzakonshme	Mbl. urgjente	Mb. solemne
Obiliq	12	3	/	2

Kuvendi i Komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2024 ka aprovuar 55 Vendime.

Gjatë vitit 2024, Kuvendi Komunal i Obiliqit ka diskutuar për çështje të ndryshme komunale dhe ka miratuar buxhetin, vendime, rregullore, plane, statute, si dhe një akt tjetër, po ashtu shumë të rëndësishëm, siq është;

Miratimi i Projekt – “Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024 – 2032.

## Rregullorët dhe aktet tjera të miratuara nga Kuvendi i Komunës për periudhën Janar- Dhjetor 2024:

1. Aprovohet Rregullorja (KO) nr.01/2024 për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësime dhënësit, nëpunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore, e dt.04.03.2024.
2. Aprovohet Rregullorja (KO) nr.02/2024, e dt.04.04.2024 Për plotësim Ndryshim të Rregullores nr.05/2022, Për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoha Komunale në Komunën e Obiliqit.
3. Aprovohet Rregullorja (KO) nr.03/2024, e dt.02.05.2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores (KO) nr.02 /2023 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Obiliqit.
4. Statuti i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Obiliq 2024, e dt.31.07.2024
5. Strategjia e Komunikimit dhe Qasja 2024 – 2026, e dt.29.11.2024.
6. Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, e dt.29.11.2024.
7. Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit 2025 -2029, e dt.29.11.2024.

## Komitetet e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Obiliqi ka Komitetet obligative siç janë:

- Komiteti për Politikë dhe Financa
- Komiteti për Komunitete

### **Komiteti Për Politikë dhe Financa**

Komiteti për Politikë dhe Financa është organi kryesor i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin:

- Të gjitha politikat
- Dokumentet fiskale dhe financiare
- Planet dhe iniciativat, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik.
- Kornizën vjetore buxhetore afatmesme
- Planin vjetor të prokurimit
- Regullorën vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat
- Planin vjetor të punës për auditimin e mbrendshëm
- Planin buxhetor vjetor, afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal,
- Marrja e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin Komunal.

Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë kësaj periudhe raportuese ka vepruar në mënyrë të rregullt dhe përbërje të plotë sipas përgjegjësisë të dhëna me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040. Ka mbajtur gjithsej 12 (dymbëdhjetë) mbledhje të hapura për publikun, gjatë vitit 2024. Komiteti ka përmbushur obligimin e tij ligjor duke trajtuar të gjitha dokumentet e rëndësishme, shqyrtimin e propozim-akteve dhe ofrimin e rekomandimeve për të gjitha çështjet që i ka pasur në rend të ditës dhe jo vetëm.

### **Komiteti për Komunitete**

Komiteti për Komunitete është komiteti i dytë obligativ i cili themelohet nga Kuvendi i Komunës dhe në përbërjen e tij mund të përfshihen edhe përfaqësues të komuniteteve që nuk përfaqësohen në Kuvend por janë banorë të komunës, pra çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga më së paku një përfaqësues në Komitet për Komunitete.

Ky komitet ka mbajtur 12 mbledhje gjatë vitit 2024, në të cilat u diskutuan çështje të ndryshme sa ju përket Drejtorive komunale dhe zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Me mbështetjen e Kryesuesit të Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës, u organizuan 4 tryeza për të shënuar këto ditë;

- 15 Shkurt – Dita Ndërkombëtare e Komunitetit Ashkali;
- 8 Prill – Dita Ndërkombëtare e Komunitetit Rom;
- 24 Qershor – Dita Ndërkombëtare e Komunitetit Egjiptian;
- 28 Shtator – Dita Ndërkombëtare e Komunitetit Boshnjak.

Në bazë të nenit 68, të LVL nr.03/L-040, neni 62 paragrafi 2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048, Kryesuesja e Kuvendit në kordinim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, organizuan diskutime publike për Planifikim të Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027.

Më datë 18.09.2024 - Kryesuesja e Kuvendit mbajti diskutim publik për: Planifikimin e Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027.

Më datë 18.09.2024 - Kryesuesja e Kuvendit mbajti diskutim public, Planifikimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027 me Kryetarët e Këshillave Lokal.

Bazuar në Planin e Punës së Kuvendit komunal, u realizua një takim pune jashtë vendit lidhur me këto tema;

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027
2. Statutit i QKMF-së, Formë Unike të Statutit të QKMF-së.
3. Strategjia e Komunikimit dhe Qasja 2024-2026

Ministria e Pushtetit Lokal është autoriteti mbikqyrës i komunave për vlersimin e ligjshmërisë së akteve, ashtu si parashihet edhe me nenit 81 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 të gjitha aktet që janë aprovuar në Kuvendin e Komunës janë dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë te organi mbikqyrës mbrenda afatit ligjor. Nëse autoriteti mbikqyrës konsideroi se një vendim apo akt tjetër nuk ishte në përputhje me Ligjet, pas pranimit të kërkesës, u rishqyrtuan nga Kuvendi Komunal.

Për të ofruar qasjen e publikut në këto të dhëna, aktet e aprovuara në KK, pas vlerësimit të ligjshmërisë, janë publikuar në faqen zyrtare elektronike të Komunës.

Monitorimi i mbledhjeve të KK dhe Komiteteve, gjatë kësaj periudhe ka qenë i vazhdueshëm. Mbledhjet janë monitoruar në vazhdimsi nga MAPL- e cila vazhdimisht përcjell punën, aktivitetet dhe verifikim e ligjshmërisë së vendimeve tona, OSBE-ja, KFOR-i, OJQ-të dhe mediat. Mbledhjet po ashtu janë transmetuar rregullisht online për qytetarët e Komunës së Obiliqit.

Vlora Mjekiqi Kabashi  
Kryesuesja e Kuvendit komunal

